



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI I LËNDËS:

GJUHË FRËNGE 1

Ngarkesa: 5 ECTS, 50 orë seminare

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti I ,semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me detyrim

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i Etikës: Kodi i Etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të përvetësojë njohuri të elementeve gjuhësore të frëngjishtes, në planin leksikor, sintaksor dhe gramatikor duke respektuar specifikat fonetike; Të zhvillojë aftësitë e vëzhgimit dhe analizës, si dhe shumë strategji të të nxënit që do të çojnë progresivisht drejt autonomisë gjuhësore; Të zhvillojë aftësitë për të zgjedhur dhe përdorur shprehjet dhe strukturat për t'u prezantuar, për të folur për veprimtaritë dhe zakonet, për të përshkruar, për t'u vendosur në kohë dhe hapësirë, për të shprehur shijet dhe mendimet, për të kërkuar dhe dhënë informacione, për të folur për ngjarje të shkuara dhe të ardhme.

Objektivat e specifike lëndore:

- Zhvillimi i aftësive të komunikimit me gojë dhe me shkrim.
- Përvetësimi i njohurive gramatikore dhe leksikore.
- Zhvillimi i kompetencës ndërkulturore dhe përdorimi i dokumenteve autentike.
- Nxitja e pjesëmarrjes aktive, punës së pavarur dhe kërkimit individual.

Rezultate të pritshme

1. Të kuptojë dhe të përdorë shprehje të thjeshta të përditshme për nevoja bazë komunikimi.
2. Të prezantojë veten dhe të japë informacion personal (emri, moshë, kombësia, adresa, etj.).
3. Të lexojë dhe të kuptojë tekste të shkurtra, njoftime, tabela, orare dhe udhëzime të thjeshta.
4. Të shkruajë mesazhe të shkurtra dhe të plotësojë formularë me të dhëna personale.
5. Të marrë pjesë në bashkëbisedime të thjeshta dhe të reagojë ndaj pyetjeve dhe udhëzimeve bazë.